



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234293
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05111213

C-IV-14- 6420

Paditësi: Y O nga Vushtria , të cilin e përfaqëson avokate F B nga Vushtria .

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore KB „Çyçavica ” Prizren e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “ Driton Hoxha ” nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me dt. 21 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar Ankesa e paditësit Y O, NDRYSHOHET Vendimi i AKP-së – Autoritetit të Likuidimit për NSH „Çyçavica ” MIT 042-0491, dt. 01.09.2014, në pjesën refuzuese për shumën 2,599.00€, ashtu që obligohet e paditura NSH „Çyçavica ” që paditësit t’ ia paguaj 2,599.00€ , Ndryshohet Vendimi i AL, MIT 042- 0492, dt. 01.09.2014, dhe obligohet e paditura NSH „Çyçavica ” për tri paga paditësit t’ ia paguaj shumën 375.00€, Ndryshohet pjesërisht në pjesën refuzuese Vendimi i AL, MIT 042- 0494, dt. 01.09.2014, ashtu që përveç shumës së pranuar për shpenzime të procedurës 403.00€, t’ i a paguajë edhe shumën 120.00€, të gjitha këto sipas nenit 40.1.7, dhe 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 .**
- II. REFUZOHET , pjesa tjetër e ankesës kundër Vendimit të AL, MIT 042- 0494, dt. 01.09.2014, në pjesën refuzuese për shpenzime të procedurës mbi shumën 120€ deri në shumën 241.00€ dhe ankesa kundër Vendimit të AL, MIT 042-0495 , dt. 01.09.2014.**
- III. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 02.10.2014, pranë DHPGJS, është parashtruar padia / ankesa e paditësit kundër të paditurit në lidhje Vendimet e AL për NSH „Çyçavica ” MIT 042- 0491, MIT 042-0492, MIT 042-0494, MIT 042- 0495.

Sipas Vendimit të AL MIT 042- 0491, dt. 01.09.2014, kërkesa e Y O, për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 1992 deri 1999, në shumën 7,228.00€, është pranuar shuma 4,397.64€, sipas nenit 40.1.17 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L -034, ndërsa është refuzuar kërkesa në shumën 2,599.00€ me arsyetim se paditësi ka një borxh të pa paguar ndaj NSH –së .

Sipas Vendimit MIT 042-0492, dt. 01.09.2014, është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e tri pagave, në shumën 375.00€, me arsyetim se kishte një marrëdhënie pune me NSH ndryshe nga marrëdhënie e punës, sepse paditësi kishte marrë me qira një dyqan dhe shuma pagat e pa paguara janë mbajtur, si kompensim për qiranë e pa paguar .

Sipas Vendimit MIT 042- 0494, dt. 01.09.2014, është kërkuar shpenzimet për procedurë gjyqësore 644.47€, janë pranuar shuma 403.00€, është refuzuar shuma 241.00€.

Sipas Vendimit MIT 042- 0495. Dt. 14.05.2014, është vendosur për kërkesë për kompensimin e ndërprerjeje së parakohshme të kontratës së punës në shumën 280.00€, ashtu që është pranuar shuma 266.00€, dhe është pranuar shuma 28.00€, për tatim në të ardhura personale dhe kontribut pensional.

Ka kërkuar të aprovohet ankesa e tij kundër Vendimeve të AL.

Ka bashkangjitur :

- Vendimin e AL MIT 042- 0491,
- Aktgjykimin C.nr. 206/2007, dt. 16.06.2009,

Më dt. 29.07.2022, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për paditësin C- IV- 14- 6420, me të cilin i ka kërkuar të plotëson ankesën e ushtruar kundër Vendimeve të AL , ndërsa për të paditurin ju është kërkuar të jep përgjigje në padi/ankesë.

Më dt. 17.08.2022, paditësi ka dorëzuar parashtresën është sqaruar në lidhje me ankesën kundër Vendimit të AL MIT 042- 0491, ashtu që një pjesë e kërkesë për pagimin e pagave për periudhën 1992 1999, është refuzuar me arsyetim se gjoja unë i kam borxh NSH-së, në shumën 2,599.00€. Ne kemi pasur një padi kundër të paditurit me të cilën kemi kërkuar të vërtetohet se ne nuk i kam borxh NSH , dhe se borxhi ndaj NSH –së , është shkaktuar nga personi M M për shpenzim të energjisë elektrike . Për ketë ekziston një aktgjykim i formës së prerë nga Gjykata Komunale në Vushtrri, C.nr. 140/2007.

Ka kërkuar që të detyrohet e paditura të paguaj pjesën tjetër të borxhit, në shumën 2,599.00€. Në parashtresë është deklaruar në lidhje me Vendimin MIT 042- 0492, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave të pa paguara në shumën 375 .00€. Paditësi ka theksuar se ka pasur pagën 125.00€, sikundër të gjithë të punësuarit të tjerë dhe jo 40 €, Ka kërkuar që të detyrohet e paditura të paguaj për tri paga shumën 375.00€.

Në lidhje me Vendimin MIT 042- 0494, është pranuar pjesërisht kërkesa për shpenzime të procedurës gjyqësore në shumën 403.00€, ndërsa është refuzuar shuma 241, €, duke u bazuar në

aktgjykim sa është gjykuar shuma për shpenzime të procedurës 403.00€, por nuk më është llogaritur taksa dhe propozimi për përmbarim të aktgjykimit pra janë krijuar shpenzime shtesë. Ka kërkuar që pjesa refuzuese ti pranohet.

Në lidhje me vendimin MIT 042- 0495, ka kërkuar ti paguhet shuma 875.00€ si kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës .

Ka bashkangjitur :

- Vendimin e AL MIT 042- 0491,
- Formularin e kërkesë kreditore në shumën 7,228€,
- Padinë dt. 25.04.2004,
- Padinë e NSH „Çyçavica ” ndaj M M, C.nr. 140/2007,
- Aktgjykimin C. nr. 140/2007, të Gjykatës Komunale në Vushtrri,
- Aktgjykimin C. nr. 206/2007, të Gjykatës Komunale në Vushtrri,
- Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë AC 9/11.
- Aktvendimin E.nr.974/06,
- Njoftimi i paditësit për AKP-në, 05.11.2014,
- Vendimin e AL MIT 042- 0492,
- Formulari i kërkesë kreditore në shumën 375€, për tri paga nga 125€, dt. 02.10.2013,
- Kopja e Librezës së punës e cila është mbyll 26.08.2013,
- Vendimin e AL MIT 042- 0492,
- Formulari i kërkesë kreditore, në shumë 644,70 €,
- Propozimi për ekzekutim dt.06.12.2011,
- Dëftesa për pagës në shumën 21 €, në shumën 16€, në shumën 15€,
- Aktvendimi për pezullim të përmbarimit E 498/11,
- Aktvendimi për shpallje jo kompetente E.nr. 498/11,
- Vendimi MIT 042- 0495,
- Formulari i kërkesë kreditore në shumën 875€.

Më dt. 24.08.2022, AKP-ja për mes përfaqësuesit të saj, ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesë së ushtruar të paditësit kundër Vendimeve të AL për NSH „Çyçavica ” MIT 042-0491, MIT 042-0492, MIT 042- 0494, MIT 042- 0495, me propozim që ankesa të refuzohet . Në parashtresë është deklaruar se NSH është në procedurë të likuidimit prej dt. 26.08.2013. Më dt. 02.10.2013, paditësi ka ushtruar kërkesat kreditore , për paga të pa paguara, në shumën 7,228.00€, për tri paga në shumën 375.00€, për shpenzimet e procedurës në shumën 644.47€, dhe për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 280€. Në parashtresë në lidhje me Vendimin e AL MIT 042- 0491, është deklaruar se paditësit ju është njohur shuma 4,860.38€, ndërsa është refuzuar shuma 2,599.00€, duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar si mbështetje në kërkesë si Aktgjykimi C. nr. 215/06, dt. 15.09.2006, me të cilin paditësi i është njohur shuma për paga të pa paguara në shumën 7,228.00€, mirëpo paditësi kishte një borxh në shumën 2,599.00€, kjo shumë ju është zbritur në këtë kërkesën për paga , prandaj AL ka vepruar sipas nenit 37.9 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Në lidhje me Vendimin MIT 042- 0492, është deklaruar se kërkesa për tri paga në shumën 375€, është refuzuar bazuar në nenin 40.1 .6, të Ligjit për AKP-në, parashtruesi kishte në marrëdhënie kontraktuale me NSH, të ndryshme nga ajo e marrëdhënies së punës pasi kishte marr me qira një dyqan dhe rezultoi që shuma për tri paga të fundit të pa paguara është mbajtur në emër të qirasë së pa paguar . Mbi këtë bazë NSH nuk i ka borxh paditësit .

Në lidhje me Vendimin MIT 042- 0494, për shpenzime të procedurës është kërkuar shuma 644,47€, AL ka pranuar shumën 403,00€ ndërsa ka refuzuar shumën 241.00€, sepse sipas Aktgjykimit C 206/2007, Gjykata ka gjykuar shumën 403.00€, shuma 241 është refuzuar pasi nuk mbështetet në këtë provë.

Në lidhje me Vendimin MIT 042-0495, me të cilën ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës , ka kërkuar shumën 280 €, është pranuar shuma 266.00€ dhe shuma 28.00€, duke marre për bazë pagën mesatare 40€, në momentin e ndërprerjeje së punësimit .

Ka bashkangjitur Vendimet e AL .

Gjykata në lidhje me rastin, ka vendosur të mbaj një seancë dëgjimore publike për tu deklaruar palët ndërgjyqës e cila është mbajtur më dt. 21.11.2023.

Në seancë për paditësin ka prezantuar avokatja F B, ndërsa për AKP-në, N M.

Në seancë dëgjimore avokatja e paditësit është deklaruar për të gjitha vendimet të cilat janë objekt i animimit.

Ka dorëzuar Aktgjykimin C. nr. 215/06, dhe aktvendimin E. Nr. 974/06.

Po ashtu edhe e paditura është deklaruar, përmes përfaqësuesit për të gjitha vendimet e AL , por nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme.

Arsyetimi Ligjor

Padia / ankesa është e bazuar.

Gjykata, pas përfundimit të procedurës me shkrim ka vendosur të caktoj seancën dëgjimore publike duke ju dhënë mundësi secilës palë të deklarohet për pretendimet e veta.

Gjykata bazuar në pretendimet e palëve dhe provat të cilat i kanë dorëzuar, ka konstatuar se nuk është si kontestues fakti se paditësi ishte punëtor i NSH „ Çyçavica ” deri në momentin kur e njëjta është privatizuar, në gusht të vitit 2013.

Gjykatës pala paditëse ja ka dorëzuar në seancë gjyqësore provën e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri C.nr. 215/06, dt. 03.07.2006, sipas të cilit NSH „Çyçavica ” ishte e obliguar që punëtorëve për pagat e pa paguara për periudhën e viti 1992 deri në vitin 1999, tu paguaj si në dispozitiv, ashtu që për paditësin me nr. rendor 97 është obliguar të paguaj shumën 7,228.00€, me kamat ligjore 4.5%, duke llogaritur prej dt. 29.06.2005. Ky aktgjykim është bërë i formës së prerë më dt. 15.09.2006.

Bazuar në propozimin për përmbarrim të paditësit për heqje të shpenzimeve të procedurës në shumën 488.30€, në lidhje me shpenzimet e shkaktuara për rastin C. nr. 206/2007, dt. 15.06.2009, paditësi kishte kërkuar shpenzimet e procedurës të shkaktuara sipas padisë për vërtetimin se i njëjti nuk i ka borxh NSH „Çyçavoca ” dhe KEK -ut në shumën 2,512.48€, për energjinë elektrike të shpenzuar . Sipas këtij aktgjykimi paditësit ju janë llogaritur shpenzimet e procedurës në shumën 403.00 €, dhe atë : për hartimin e padisë 50€, për hartimin e ankesës 50€, dhe për tri seanca 303€, për përfaqshim nga avokatit .

Me provën e dokumentit të librezës së punës paditësi kishte qenë i punësuar më dt. 01.08.1975, deri më dt. 31.12.1983, me përvojë pune 8 vite e 4 muaj e 30 ditë, pastaj prej dt. 01.01.1984 deri më dt. 26.08.2013, kur ju është mbyllur librezja me përvojë pune 29 vite, 7 muaj e 25 ditë, ose mbi 35 vite përvojë pune.

Gjykata vlerëson se me Vendimin e AL MIT 042- 0491, paditësit ju është njohur shuma 4,860.38€, nga pjesa e kërkesës në shumën 7,228.00€ ndërsa ju është refuzuar shuma 2,599.00€, duke u mbështetur në dokumentacionin sipas të cilit paditësi i kishte borxh të pa paguar NSH – së, për periudhën e viti 2001 deri 2007, për qiranë e dyqanit „M ” aset i NSH –së, dhe kjo shumë është refuzuar duke u mbështetur në nenin 37.9 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034. Me rastin e pranimin të shumës 4,860.38€, nga pjesa e kërkesës 7,228.00€, është bazuar në Aktgjykimin C. nr. 215/06.

Paditësi në ankesë kundër këtij Vendimit të AL pretendon se ka ekzistuar një borxh për energjinë e shpenzuar në lokalin aset i NSH –së, por të cilin borxh ai nuk e kishte shkaktuar por e kishte shkaktuar personi tjetër , për çka ka dorëzuar si provë Aktgjykimin C.nr. 206/2007, dt. 15.06.2009.

Gjykatës as paditësi dhe as i padituri nuk ia kanë dorëzuar provën dëshminë se kanë pasur një marrëdhënie kontraktuale të qirasë për ndonjë hapësirë afariste (lokal), pronë e NSH –së, dhe derisa i padituri në Vendim të saj ka konstatuar ekzistimin e një borxhi nga baza e kontratës, së qirasë ndërsa paditësi pretendon se të paditurit NSH nuk i kishte borxh në emër të energjisë elektrike.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret AKP/AL nuk ka ofruar asnjë dëshmi provë materiale, sipas nenit 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 , si për ekzistimin e kontratës së qirasë për lokalin afarist të NSH sikundër as për periudhën e borxhit të pretenduar dhe se në rastin konkret kërkesa e paditësi për paga të pa paguara për periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 1999 në shumën 7,228.00€, është e gjykuar me Aktgjykimin C. nr. 215/2006, që është bërë i formës së prerë dhe AL nuk ka autorizim ligjor që këtë kërkesën e gjykuar ta kushtëzoi gjegjësisht kompensoi me një kërkesë tjetër të NSH nga një raport juridik i kontratës së qirasë përderisa nuk kemi një marrëveshje në mes palëve për kompensim të kërkesave, ose ndonjë Vendim gjyqësor me të cilin është obliguar paditësi që NSH –së t’ ia paguaj borxhin e qirasë së pretenduar në supozim të ekzistimit të tij . Me Vendim AKP/AL, arsyetim të tij askund nuk është sqaruar në lidhje me pretendimin për borxhin e krijuar të paditësit ndaj të paditurit, sikundër as për bazën juridike të borxhit. Po ashtu edhe në parashtrësë të mbrojtjes por edhe në seancë dëgjimore publike ka dështuar të jap sqarime dhe të dorëzoi prova si : kontratën e qirasë, prova për dorëzimin e faturave mujore për qiranë te paditësit, por të cilat nuk i ka paguar ose ndonjë provë se NSH, e ka thirr paditësit të paguaj borxhin e pretenduar apo të ket iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore për pagimin e borxhit . Gjykata vlerëson se në rastin konkret AKP/AL për NSH „ Çyçavica ” nuk ka bazë ligjore që kërkesën e paditësit të gjykuar me Aktgjykim të formës së prerë ta kushtëzoi me një kërkesë tjetër për të cilën nuk kemi marrëveshje të kompensimit në supozim se ajo kërkesë është e bazuar nga raporti juridik i pretenduar .

Gjykata për këtë arsye e pranoi kërkesën e paditësit dhe e ndryshoi Vendimin e AL MIT 042-0491 , në pjesën refuzuese, ashtu që e detyroi të paditurin që t’ i paguaj edhe shumën 2,599.00€, si në dispozitiv duke zbatuar nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit .

Gjykata ka vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me mos pagesën e tri pagave të pa paguara në shumën 375.00€, pavarësisht nga fakti se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë të dëshmisë në lidhje me lartësinë e pagës mujore, sikundër që nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se

për cilën periudhë kohore nuk ju janë paguar pagat, por duke marr për bazë Vendimin e AL MIT 042- 0492, sipas të cilit kërkesa për tri paga të pa paguara në shumë 375.00€ është refuzuar nga baza e kompensimit të borxhit për qira, pa u vërtetuar ekzistimi i kontratës së qirasë, çmimi i qirasë mujore dhe periudha kohore e mos pagesës së qirasë, sikundër edhe pa ekzistimin e marrëveshjes për kompensim, ky veprimi i AL nuk mund të pranohet sepse si i tillë është i kundërligjshëm.

AKP/AL me asnjë provë të vetme nuk ka provuar ekzistimin e kërkesë së NSH-së ndaj paditësit, dhe se kërkesa e paditësit për pagimin e tri pagave të pretenduara nuk mund të kushtëzohet me pagimin e borxhit që rrjedh nga një marrëdhënie juridike tjetër për të cilën nuk provohet.

Gjykata pa u lëshuar në vërtetimin e faktit të mos pagesë së tri pagave dhe të lartësisë, pasi këto fakte nuk janë kundërshtuar nga AL, sikundër që e paditura e ka dosjen e paditësit si punëtor, vlerëson se në rastin konkret pagesa e tri pagave është e njohur sipas nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, ndërsa kërkesa e NSH –së nuk është e provuar me asnjë provë materiale, përkundër faktit se Gjykata ja dha mundësin AKP-së të dorëzoi prova si me parashtrësë të mbrojtjes ashtu edhe në seancë dëgjimore publike.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar dhe Vendosi ta ndryshoi Vendimin e AL MIT 042- 0492, ashtu që e detyroi të paditurin NSH që paditësit t’ ia paguaj tri pagat e pa paguara në shumën 375.00€, si në dispozitiv .

Me rastin e njohjes së një të drejte të tillë, të paditësit në pagesën e tri pagave , gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me pagimin e shpenzimeve të procedurës të shkaktuara sipas Aktgjykimit C. nr. 206/07, të Gjykatës Komunale në Vushtri që AL me Vendimin MIT 042- 0494, nga shuma e kërkesë 644.47€, ka pranuar shumën 403.00€, ndërsa ka refuzuar kërkesën në shumën 241.00€, duke u mbështetur në këtë Aktgjykim C. nr. 206/07.

Në lidhje me ankesën paditësi, ankesën e vet e ka mbështetur në provën e propozimit për përmbarim të hartuar nga avokati, E nr. 498/11, të ushtruar në Gjykatën Komunale në Vushtri dhe në fletë pagës për taksë gjyqësore për parashtrësë të përmbarimit që është paguar më dt. 06.12.2011, në shumën 16.00 €.

Sipas formularit të kërkesës kreditore, paditësi kishte kërkuar 644.70 €, por këtë shumë nuk e kishte specifikuar , përveç specifikimit të bërë në propozim për përmbarim .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret , kërkesa e paditësit për pjesën refuzuese me Vendimin e AL është pjesërisht e bazuar, AL me rastin e vendosjes është dashur që paditësit t’ ia pranoi edhe shpenzimet e procedurës për iniciimin e procedurës përmbarimore gjyqësore dhe atë : për hartimin e propozimit për përmbarim nga avokat në shumën 104.00 €, dhe për taks gjyqësore në shumën 16,00€ ose shumën e tërësishme 120.00€, ndërsa pjesë tjetër e shumës mbi 120.00€ deri në shumën 241.00€, është e pa bazuar, dhe si e tillë ajo është refuzuar .

Bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike, gjykata edhe vendosi ta ndryshoi Vendimin e AL MIT 042- 0494, në pjesën refuzuese, si në dispozitiv .

Gjykata ka vlerësua edhe pretendimet ankimore të paditësit kundër Vendimit të AL MIT 042- 0495, me të cilin AL ka pranuar në tërësi kërkesën kreditore për kompensim të ndërprerjes të

parakohshme të kontratës së punës , në shumën e kërkuar 280.00€, nga e cila shumë ju është pranuar shuma 266.00€, dhe shuma 28.00€, për tatim në të ardhura dhe për kontribut pensional. Sipas formularit të kërkesë kreditore të dorëzuar nga vet paditësi ai kishte kërkuar fillimisht shtat paga nga 125.00€, ose shumën 875.00€, por në të njëjtin formular është kërkuar shtat paga nga 40.00€, në shumën 280.00€, ashtu që në lidhje me këtë situata, nuk është sqaruar as paditësi dhe as e paditura, me parashtrësia dhe në seancë dëgjimore . Kështu që AL si kërkesë e ka pranuar shumën 280.00€. Në rastin konkret gjykata vlerëson se çdo kërkesa kreditore që ushtrohet te AL , pas përfundimit të shqyrtimit dhe vendosjes me Vendim të AL, në procedurë gjyqësore, paditësi nuk mund të zmadhoi kërkesën kreditore, në fazën e ankimimit.

Gjykata për këtë arsye ankesën e paditësit kundër Vendimit të AL MIT 042- 0495 e refuzoi ankesën dhe vendosi si në dispozitiv.

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar